

PROFILI SHOQËROR

PJESA I

MJEDA: ANDRRA E JETËS – ZOGA (KËNGA II)

Prej nën një tjegllat kish dalë si
j'tra¹,
Ku një mij tesha² vëloshin pa da;
Përmbi shpi ndihej tuj rrahun
troka³

E ushtote toka.

Prej kambësh t'baktive. Ka dalë
Harapi⁴
Heret e shpatit delet ia hapi;
Ka dalun Mica⁵ me lopë
t'mëdhaja

Nëpër ograja.

Kur u zgjue Zoga vojt te balkoni,
E pau se bleta vëlote te zgjoni;
Pau se n'at nade⁶ poshtë një
lavnuer⁷
Kish ba një shpuer⁸.

Tuj sjellun krahnin këndote me
vedi,
E i rridhte krahve një si valë dedi,
Ku shndriçëm dielli lëshote si
zhgjeta
Rrezet e veta.

Reze, flakë arit. Po rrotull fëtyra⁹
E fushës kish nd'rue, kish
ndrruemun zyra¹⁰

E bimës e e pemve, përmi balkue
Deri kish ndrue

Erë filcigeni¹¹ po i vite 'j tjetër
Erë pors makthit¹²; e rruga e
vjetër
Nën shpi, mbas gardhit, por si një
dritë

Shkote tuj qitë.

Nuk e kish vrumun¹³ kurr ndër dit'
t'veta¹⁴
At rrugë n'balkue. Ktheshin me
çeta¹⁵
Asajt¹⁶ katundsit tuj dalë pa pra
E ajo s'kish pa.

U nis te puna mërziçëm¹⁷. Nisi
Ndër penj sovajkën¹⁸ e shpata¹⁹
krisi
Cirlikne²⁰ rrotllat posht' e përpjetë
Nën kambë të shpejtë

E vojt n'dritore prap. Ndoshta
begu
Ka mbërri te rruga e pret te shtegu
Veshun me t'arta, mbi j'pullali
Për bukuri.

Nuk ishte begu: në diell t'valtë

Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I

Veç dy dallëndyssha bajshin do
baltë,
Baltë e kashtare për çerdhe t'vet,
Se Shën Ejlli a nget²¹.

Ndoshta po avitet një djal' i ri
I holl e i gjatë posi 'j selvi,
Me rryp rreth brezit, me një
gjashtore²²

E 'j kacatore²³.

Nuk erdhi djali: veç dy bylbyla,
Nji n'drandofille, nji ndër
zymbyla,
Përmallshëm thrrasin e shoqi-
shojnë

Me kangë gazmojnë.

Fjalor

1. *si j'tra* – një rreze drite depërton nëpër çatinë e shtëpisë
2. *tesha* – sende, pluhur, grimca
3. *troka* – këmbana e deleve
4. *Harapi* – bari i dhenve
5. *Mica* – bareshë e vogël
6. *nade* – mëngjes
7. *lavruer* – bujk
8. *kish ba një shpuer* – Kishte përfunduar një rrip toke të punuar.
9. *fëtyra* – pamja, gjendja
10. *zyra* – puna
11. *filcigeni* – borzilok
12. *makthi* – lloj luleje e verdhë
13. *vrurun* – vënë re
14. *ndër dit' t'veta* – në jetën e vet
15. *çeta* – grumbuj
16. *asajt* – andej, nëpër atë vend
17. *mërziçëm* – pa qejf, e mërziur
18. *sovajkë* – gjepi i tezgjahut
19. *shpata* – krehri ku futen peri që do të endet
20. *cirlikne* – zhurmë që bën tezgjahu
21. *Shën Ejlli a nget* – dita e rrushajave, 24 marsi që paraljmëron ardhjen e pranverës
22. *gjashtore* – revole me gjashtë fishekë
23. *kacatore* – pushkë e gjatë

Matura Shtetërore 2006, Teste

Për pyetjet 1-5 rretho vetëm shkronjën përbri përgjigjes së saktë.

1. Në këtë fragment poeti i këndon: **1 pikë**
A) dashurisë dhe lumturisë.
B) dhimbjes së Lokes.
C) mallit për Trinën.
D) madhësisë së jetës së fshatit.
2. Në poemën *Andrra e jetës* zotëron ligjërimi: **1 pikë**
A) epik
B) satirik
C) lirik
D) dramatik
3. Ngjarjet në poemë janë vendosur në: **1 pikë**
A) Shqipërinë e Mesme.
B) malësinë shqiptare.
C) bregdetin jugor.
D) trojet arbëreshe.
4. Dashuria, sakrificat vetëmohuese deri në stoicizëm mbinjerëzor mishërohen te: **1 pikë**
A) poeti
B) Trina
C) Zoga
D) Lokja
5. *Andrra e jetës* është një poemë romantike me elementë: **1 pikë**
A) të filozofisë së absurdit.
B) metaforikë e simbolikë.
C) të realizmit kritik.
D) të epikës legjendare.
6. Gjej vargjet në të cilat shprehet optimizmi dhe shpresa për ditë më të bukura. **2 pikë**

Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I

7. Gjej në këtë fragment dy figura stilistikore dhe shpjego rolin që luajnë ato. **4 pikë**
Figura: _____
Shpjegimi: _____

Figura: _____
Shpjegimi: _____

8. Gjej detajet poetike me të cilat jepet ardhja e stinës së pranverës (strofat 1-4) dhe shkruaj nëse ato i japin poezisë ngjyrim romantik apo realist. Pse Zoga i vë re gjithë këto ndryshime pikërisht tani? A ka lindur tek ajo dashuria apo është duke u përgatitur për t'u dashuruar? Ilustroje mendimin tënd me detaje e vargje. **4 pikë**
9. Mjeda është mjeshtër i fjalës poetike. Mbështete këtë mendim duke u bazuar në elementë të vargëzimit (p.sh numri i rrokjeve, formimi i strofës, rima). **4 pikë**
10. Mesazhi i poemës është se jeta i ngjan një ëndrrë të shkurtër e shpesh drithëronjëse, por megjithatë ia vlen ta jetojmë e ta gëzojmë. Duke patur parasysh këtë fragment dhe poemën në tërësi vazhdoje këtë ide sipas mendimit tënd. **6 pikë**

PJESA II

HEMINGUEJ: LAMTUMIRË ARMË (FRAGMENT)

Infermierja hapi derën dhe më bëri shenjë me gisht të hyja. Hyra në dhomë. Ketrin nuk i ngriti sytë kur hyra. Iu afrova shtratit. Doktorin qëndronte në këmbë në anën tjetër. Ketrin më vështroi dhe vuri buzën në gaz. U kërrusa mbi shtratin e saj duke qarë.

- I dashuri im i shkretë,- tha Ketrin me zë shumë të ulët.

Dukej krejt e përhumur.

- S'ke gjë, Keti,- i thashë. – Do të shërohesh.

- Do të vdes,- tha ajo. Heshti dhe pastaj foli prapë: - Dhe nuk dua...Jo, nuk dua.

I kapa dorën.

- Mos më prek,- tha.

Ia lashë dorën. Ketrin bëri buzën në gaz.

- I dashuri im i shkretë...Po, po, prekmë sa të duash.

- Ti do të shërohesh, Keti. E di se do të shërohesh.

- Doja të shkruaja një letër për çdo rast, po ja që nuk e shkrova.

- Mos do të shkoj të sjell një prift apo ndonjë që ke dëshirë ta shohësh?

- Vetëm ty të dua,- qe përgjigjja. Pastaj, pas një heshtjeje: - Frikë unë nuk kam, por vdekjen e urrej.

- Nuk duhet të flisni aq shumë, - i tha doktorin.

- Mirë,- iu bind Ketrin.

- Mos dëshironi ndonjë diçka? Ç'mund të bëj për ty, Keti?

Ketrin bëri buzën në gaz.

- Jo, - tha. Pas një heshtjeje të shkurtër shtoi: - Ato që i kemi bërë bashkë, nuk do t'i bësh me grua tjetër, mirë? Nuk do t'i thuash askujt ato që më thoshe mua?

- Jo, kurrë.

- Megjithatë dua që të kesh gra të tjera.

- Unë nuk dua.

- Po flisni shumë, - ndërhyri përsëri doktorin. – Zoti Henri duhet të ikë. Mund të vijë pak më vonë. Ju nuk do të vdisni. Mos flisni marrëzira.

- Mirë, - tha Ketrin.

- Natën do të vij të rri me ty, - i thashë me pëshpërimë.

Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I

- Dilni nga dhoma, ju lutem,- m'u drejtua doktori. – Ajo nuk duhet të flasë.

Ketrin, krejt e hirnosur, më shkeli syrin.

- Do të rri te dera, - i thashë.

- Mos u bëj merak, i dashur,- më tha Ketrin. – Nuk kam frikë fare. Është vetëm shaka e fëlliqur.

- Trimëresha ime e dashur...

Prita në korridor. Prita një copë herë të madhe. Infermierja hapi derën e m'u afrua.

- Zonja Henri është shumë keq, - më tha.- Kam shumë frikë mos...

- Vdiq?

- Jo, por ka humbur ndjenjat.

Me sa duket hemorragjia s'po i ndërpritej, masat e marra nuk dhanë asnjë rezultat. Hyra në dhomë dhe qëndrova pranë Ketit deri sa dha shpirt. Nuk u përmend më, vdekja që e shpejtë.

Në korridor doktori më tha:

- S'keni ç'bëni më këtu. T'u shpie në hotel?

- Jo, ju faleminderit. Dua të rri këtu edhe pak.

- Nuk di ç't'ju them. Asgjë nuk mund t'ju them...

- Jo, - i thashë. – Ju s'keni ç'të më thoni.

- Lamtumirë, - më tha. – Vërtet nuk dëshironi t'ju shpie në hotel?

- Jo. Ju faleminderit.

- Është e vetmja gjë që mund të bënim,- më tha. – Operacioni provoi se...

- Nuk dua të më thoni asgjë, - e ndërpreva.

- Dëshiroj t'ju shpie në hotel.

- Jo, ju faleminderit.

Doktori u largua duke ecur korridorit. Iu afrua derës së dhomës.

- Tani nuk mund të hyni ende.

- Dilni, - i thashë. – Ju dhe ajo tjetra.

Si dolën, mbylla derën e shova dritën, e kuptova se gjithçka tani ishte e kotë. Ishte njëllor si t'i thosha lamtumirë një statuje. Pas pak dola dhe ika nga spitali. U ktheva në hotel në mes të shiut.

Matura Shtetërore 2006, Teste

Për pyetjet 11-15 rretho vetëm shkronjën përbri përgjigjes së saktë.

- 11.** Ky roman rrëfen për: **1 pikë**
A) luftën dhe dashurinë.
B) aventurat dhe sfidat.
C) vetminë dhe kotësinë.
D) vetmohimin dhe përlësinë.

- 12.** Ndjenja që përshkon këtë fragment është ajo e: **1 pikë**
A) nostalgjisë.
B) entuziazmit.
C) dhimbjes.
D) shpresës.

- 13.** Pas vdekjes së Ketrinës, Henri refuzon gjithçka që i ofron doktori, sepse: **1 pikë**
A) e fajëson doktorin për vdekjen e saj.
B) do të mbyllet në dhimbjen e vet.
C) nxiton të largohet për në hotel.
D) ka njerëz më të afërt që mund ta ndihmojnë.

- 14.** Qëndrimi i Ketrinës para vdekjes është: **1 pikë**
A) pesimist.
B) i trembur.
C) i alarmuar.
D) i fortë.

- 15.** Henri, në çastet e fundit, i premtun Ketrinës: **1 pikë**
A) besnikëri të përjetshme.
B) se do ta jetojë jetën si t'i vijë.
C) se do t'i kushtohet veprave të bamirësisë.
D) rikthimin në frontin e luftës.

- 16.** Ndiq dialogun midis Henrit dhe Ketrinës dhe përpigu të kuptosh lidhjen midis tyre. Sa e thellë dhe e qëndrueshme është ajo? Ilustroje mendimin me detaje nga fragmenti. **3 pikë**

Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I

17. I gjithë ky fragment karakterizohet nga një dialog i shkurtër dhe i shpejtë. Cila është arsyeja e përdorimit të një teknike të tillë nga ana e autorit? Si gjen zbatim në të *parimi i ajsbergut*? **4 pikë**
18. Personazhet e Heminguejit janë heronj tragjikë. Cili është burimi i fatalitetit në jetën e Ketrinës dhe Henrit? **3 pikë**
19. Cilat janë disa nga ndjenjat që shoqërojnë Henrin dhe Ketrinën? A krijon ky fragment përfytyrimin e një drame dashurie realiste? Përpiqu të argumentosh përgjigjen. **4 pikë**
20. Lexo me kujdes pjesën e fundit të fragmentit. Ndal në detajin e *dritës së fikur, statujës dhe shiut* dhe nëntekstit që ato ofrojnë. Shpreh mendimin tënd në formën e një eseje argumentuese. **6 pikë**